



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.1017/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj kryetar, Delushe Halimi dhe Ramiz Kuqi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses E.D nga komuna e Klinës, kundër të paditurës “Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale” - Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, për shkak të anulimit vendimit të të paditurës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1061/2019, të datë 25.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuara ankesa e të paditurës “Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale” - Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative, A.nr.1061/19, i datë 25.10.2021, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar A.nr.1061/19, të datës 25.10.2021, në pikën I të dispozitivit të aktgjyqimit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses E.D nga komuna e Klinës. Në pikën II të dispozitivit janë anuluar vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë me nr. 4914 të dt. 07.09.2018 dhe vendimi i datës 17.12.2018. Në pikën III të dispozitivit paditëses i është njohur e drejta e kompensimit të kujdestarit personal – nënës së saj dhe është obliguar e paditura që tja kompensoj paditëses dhe atë nga paraqitja e kërkesës me datë 25.04.2018 e për çdo muaj në vlerën e përcaktuar me ligj. Në pikën IV të dispozitivit ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Në pikën V të dispozitivit secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të: të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit t'a aprovoj ankesën si të bazuar, të prishet aktgjykimi dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se: Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështjet Administrative, më datën 06.05.2019, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit -aktit administrativ të paditurës “Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale” nr. 4914 të datës 10.08.2018 me të cilin vendim i është refuzuar ankesa paditëses për njohjen e të drejtës në përcjellje të personit me aftësi të kufizuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, me aktgjykimin A.nr. 892/18 të datës 20.02.2020 e ka aprovuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit). Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër tjerash ka konstatuar se: nga provat e administruara ja fali besimin raporteve mjekësore të ku paditëses, e në veçanti ia fali besimin ekspertizës së ekspertëve mjekësor të datës 08.09.2021 ku është vërtetuar se paditësja është person plotësisht e paafët për jetë të pavarur dhe ka nevojë për përcjellje të personit të tretë. Në këtë drejtim Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike, në procedurën gjyqësore kishte administruar një mori provash materiale si në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë - Departamenti për Çështjet Administrative është bazuar të nenit 5, 6, 29, 38 dhe nenit 46, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata e Apelit nuk e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar më ankesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë-*

treguar fare arsytet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthëniet midis asaj që në arsytet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit” dhe nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Si rezultat i kësaj, Gjykata e Apelit, vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës. Bazueshmëria e këtyre pretendimeve rrjedh edhe nga fakti se: dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë jo i plotë dhe i papërmbarueshëm, pasi që nuk dihet ***se sa është shuma në të holla*** që detyrohet e paditura tja pagauj paditëses për këtë lloj kompensimi, andaj si i tillë është i dispozitivi është i papërmbarueshëm.

Andaj gjykata e shkallës së parë nuk ka hartuar dispozitivin e aktgjykimit ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 143 dhe 146 të LPK -së dhe lidhur me nenin 63 të LKA –së, dhe si i tillë nuk është i plotë. Nga arsytet e lartpërmendura, Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar duhet të priset, dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm.

Mbi bazën e të lartcekurave gjykata e shkallës së dytë gjeti se aktgjykimi i ankimuar, është marrë me shkelje të dispozitave procedurale të cekura si më lartë, për çka edhe i njëjti u dashtë të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, ngase gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur kushte që të njëjtin t’a ndryshoj.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në procedim të serishëm të evitoj të metat e sipërpërmendura, lidhur me këtë çështje administrative të vendos brenda kërkesave së palëve ndërgjyqëse, ***të vërtetoj me provë se sa është shuma për këtë lloj kompensimi*** dhe pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, dhe rrethanave të sipërmendura të merr vendim të drejtë, i cili vendim duhet të përmbajë dispozitivin e qartë, të kuptueshëm, të plotë dhe të përmbarueshëm, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 143 dhe 146 të LPK –së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (c) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.1017/21, datë 31.01.2022

Kryetari i kolegjit- Gjyqtari,
Mehmet Ndrecaj